

VENDIM
Nr. 219, datë 9.4.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT, PËR PËRJASHTIMIN E NDËRSJELLË TË
KËRKESËS PËR VIZË PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE TË ZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për përjashtimin e ndërsjellë të kërkesës për vizë për mbajtësit e pasaportave të zakonshme, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT PËR PËRJASHTIMIN E
NDËRSJELLË TË KËRKESËS PËR VIZË PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE TË
ZAKONSHME**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Azerbajxhanit, më poshtë referuar si “Palët”,

Me dëshirën për të inkurajuar zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe duke synuar lehtësimin e lëvizjes së shtetasve të shteteve të tyre,

kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Shtetasit e shteteve të njëres palë, mbajtës të pasaportave të zakonshme, do të përjashtohen nga kërkesat për vizë për të hyrë, për të dalë ose kaluar transit përmes territorit dhe për të qëndruar në territorin e shtetit të palës tjetër për një periudhë jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda çdo periudhe 180-ditore (njëqind e tetëdhjetë ditore).

Neni 2

1. Shtetasit e shteteve të secilës palë, mbajtës të pasaportave të zakonshme, do të hyjnë, kalojnë transit dhe dalin nga territori i shtetit të Palës tjetër përmes të gjitha pikave të kalimit kufitar shtetëror të hapur për transport ndërkombëtar pasagjerësh.

2. Kohëzgjatja e pasaportave të zakonshme të shtetasve të secilës nga Palët do të jetë e vlefshme për të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së synuar të nisjes nga territori i shtetit të palës tjetër.

Neni 3

1. Shtetasit e shtetit të secilës palë do të respektojnë legjislacionin kombëtar të Palës tjetër gjatë qëndrimit të tyre në territorin e shtetit të asaj Palë.

2. Secila Palë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, do të njoftojë me shkrim Palën tjetër brenda periudhës më të shkurtër të mundshme për të gjitha ndryshimet në legjislacionin e saj kombëtar në lidhje me hyrjen, lëvizjen dhe qëndrimin e shtetasve të huaj në territorin e shteteve të tyre.

Neni 4

Secila Palë do të rezervojë të drejtën të refuzojë hyrjen e personave të specifikuar si “persona non grata” ose të personave të padëshiruar të Palës tjetër ose të ndërpresë qëndrimin e personave të tillë në territorin e saj.

Neni 5

1. Në rast të humbjes, vjedhjes ose dëmtimit të pasaportave të zakonshme të shtetasve të një Shteti të njërës Palë në territorin e Shtetit të Palës tjetër, mbajtësi i këtyre pasaportave duhet të informojë autoritetet përkatëse të shtetit pritës.

2. Në vend të një pasaporte të zakonshme të humbur, të vjedhur ose të dëmtuar, Misioni Diplomatik ose zyrat konsullore të shtetit, në të cilin mbajtësi është shtetas, do të lëshojnë dokument të ri udhëtimi dhe do të informojnë për këtë autoritetet përkatëse të shtetit pritës.

Neni 6

1. Palët, nëpërmjet kanaleve diplomatike, do të shkëmbejnë ekzemplarët e pasaportave të tyre të zakonshme të vlefshme, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse paraqiten formularë të rinj të rregullt të pasaportës ose modifikohen ata ekzistues, secila Palë do t'i japë palës tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, ekzemplarë të pasaportave të reja dhe informacion mbi aplikimin e tyre, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të aplikimit të tyre.

Neni 7

1. Palët rezervojnë të drejtën të pezullojnë përkohësisht, plotësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik dhe shëndetit publik.

2. Palët do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë, por jo më vonë se 48 orë, nëpërmjet kanaleve diplomatike për vendimin e tyre për pezullimin dhe rinovimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Pezullimi nuk do të prekë të drejtat e shtetasve që kanë hyrë tashmë në territorin e Shtetit të Palës tjetër.

Neni 8

Çdo ndryshim mund të bëhet në këtë Marrëveshjeje me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve.

Këto ndryshime do të bëhen në formën e protokolleve të veçanta, që janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje, dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Çdo dallim ose mosmarrëveshje që lind nga zbatimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet konsultimeve ose negociatave ndërmjet Palëve.

Neni 10

1. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë kohore të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim të Palëve, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që të gjitha procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje kanë përfunduar.

2. Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke njoftuar për denoncimin Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje do të përfundojë 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Baku, më 1.3.2024, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, azere dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën anglisht do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
AZERBAJXHANIT